V E N D I M
Nr. 614, datë 17.11.2000

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 3 të vendimit nr.335, datë 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave, shtohen:

"- Sekretari i përgjithshëm, në ministri, në Gjykatën Kushtetuese, në Avokatin e Popullit, në Kontrollin e lartë të Shtetit dhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- Kancelari i Gjykatës së Lartë.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta